UDHËZIM
Nr.10, datë 30.5.2011

PËR MIRATIMIN E TIPIT TË TRAKTORËVE BUJQËSORË OSE TË PYLLTARISË, RIMORKIOVE DHE RIMORKIATORËVE TË TYRE TË NDËRKËMBYESHËM, SË BASHKU ME SISTEMET, PJESËT PËRBËRËSE DHE NJËSITË E TYRE TË NDARA TEKNIKE

Në mbështetje të pikës 4, neni 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 105, 106, 107 dhe 108 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, neneve 257 - 276 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.153, datë 7.4.2000 "Rregullorja e zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; direktivës 2003/37/KE, datë 26.5.2003 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit "Për miratimin e tipit të traktorëve bujqësorë ose të pylltarisë, rimorkiove dhe rimorkiatorëve të tyre të ndërkëmbyeshëm, së bashku me sistemet, pjesët përbërëse dhe njësitë e tyre të ndara teknike, dhe që shfuqizon direktivën 74/150/KEE" dhe të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane dhe shteteve të tyre anëtare, protokolli 5 "Mbi transportin tokësor", Ministri i Punëve Publike dhe Transportit

UDHËZON:

Neni 1
Objekti

1. Ky udhëzim, në harmoni të plotë me direktivën 2003/37/KE, zbatohet për miratimin e tipit të automjeteve të ndërtuara në një ose më shumë faza. Ajo zbatohet për automjetet e përcaktuara në nenin 2(d), të cilat kanë një shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më pak se 6 km/orë.

Ky udhëzim, në harmoni të plotë me direktivën 2003/37/KE, zbatohet edhe për miratimin e tipit KE të sistemeve, pjesëve përbërëse dhe njësive të veçanta teknike të synuara për përdorim në këto automjete.

2. Ky udhëzim, në harmoni të plotë me direktivën 2003/37/KE, nuk zbatohet për:

a) miratimin e automjeteve të vetme.

Megjithatë, kjo procedurë mund të zbatohet për kategori të veçanta automjetesh që hyjnë brenda objektit të direktivës 2003/37/KE, dhe për të cilat miratimi i tipit KE është i detyrueshëm;

b) makineri të projektuar posaçërisht për përdorim në pylltari, si për shembull traktorë të rëndë për transportin e druve dhe makineri për ngritjen e druve, siç përcaktohet në standardin ISO 6814:2000;

c) makineri pylltarie të bazuar në shasinë për pajisjet për heqjen e dherave, siç përcaktohet në standardin ISO 6165:2001;

d) makineri të ndërkëmbyeshme që ngrihet plotësisht nga toka kur automjeti në të cilin është lidhur, përdoret në rrugë.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllime të këtij udhëzimi, në harmoni të plotë me direktivën 2003/37/KE:

a) "Miratim tipi KE" nënkupton procedurën me anë të së cilës një shtet anëtar vërteton se një tip automjeti, sistemi, pjesë përbërëse ose njësie të veçantë teknike plotëson kërkesat përkatëse teknike të direktivës 2003/37/KE; miratimi i tipit KE i sistemeve, pjesëve përbërëse dhe njësive të veçanta teknike mund të referohet gjithashtu si "miratimi i tipit KE i pjesës përbërëse".

b) "Miratimi i tipit KE në shumë faza" nënkupton procedurën me anë të së cilës një ose më shumë shtete anëtare vërtetojnë se në varësi të statusit të përfundimit një tip i paplotë ose i përfunduar automjeti përmbush kërkesat përkatëse teknike të direktivës 2003/37/KE.

c) "Miratim i automjeteve të vetme" nënkupton procedurën me anë të së cilës një shtet anëtar vërteton se një automjet i miratuar individualisht përmbush kërkesat kombëtare.

d) "Automjet" nënkupton çdo traktor, rimorkio ose rimorkiator të ndërkëmbyeshëm, qoftë i plotë, i paplotë ose i përfunduar që synohet të përdoret në bujqësi ose pylltari.

e) "Kategori automjeti" nënkupton çdo grup automjetesh që kanë karakteristika identike projektimi.

f) "Tip automjeti" nënkupton automjetet e një kategorie të veçantë që nuk ndryshojnë në aspektet

thelbësore të përmendura në shtojcën II, kapitulli A; janë të lejueshme variantet dhe versionet e ndryshme të një tipi automjeti të përcaktuara në shtojcën II, kapitulli A.

g) "Automjet bazë" nënkupton çdo automjet të paplotë, numri i identifikimit i të cilit ruhet gjatë fazave të mëtejshme të procesit me shumë faza të miratimit të tipit KE.

h) "Automjet i paplotë" nënkupton çdo automjet që ka ende nevojë të plotësohet në të paktën një fazë të mëtejshme, me qëllim përmbushjen e të gjitha kërkesave përkatëse të direktivës 2003/37/KE.

i) "Automjet i përfunduar" nënkupton një automjet që rezulton nga procesi i miratimit të tipit KE në shumë faza, që përmbush të gjitha kërkesat përkatëse të direktivës 2003/37/KE.

j) "Traktor" nënkupton çdo traktor të motorizuar bujqësor ose pylltarie, të pajisur me rrota ose zinxhirë, i cili ka të paktën dy boshte dhe shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më pak se 6 km/orë, funksioni kryesor i të cilit qëndron në forcën e tij tërheqëse dhe që është projektuar posaçërisht për të rimorkiuar, shtyrë, transportuar dhe aktivizuar pajisje të caktuara të ndërkëmbyeshme të projektuara për kryerjen e punës bujqësore ose të pylltarisë ose për të tërhequr rimorkio bujqësore ose të pylltarisë; ai mund të përshtatet për të transportuar një ngarkesë në kontekstin e punës bujqësore ose pylltarisë dhe/ose mund të pajiset me ndenjëset e pasagjerëve.

k) "Rimorkio" nënkupton çdo rimorkiator bujqësor ose të pylltarisë, të synuar kryesisht për të transportuar ngarkesa dhe i projektuar për t'u rimorkiuar nga një traktor për qëllime bujqësore ose pylltarie; rimorkioja pjesa e ngarkesës e të cilave përballohet nga automjeti tërheqës, hyn brenda kësaj kategorie; çdo automjet i lidhur me një traktor dhe që ndërfut në mënyrë të përhershme një instrument asimilohet në një rimorkio bujqësore ose pylltarie nëse koeficienti i masës bruto të lejueshme teknikisht ndaj masës së pangarkuar të atij automjeti është i barabartë ose më i madh se 3,0 dhe nëse automjeti nuk është projektuar për të përpunuar materiale.

l) "Rimorkiator i ndërkëmbyeshëm" nënkupton çdo instrument të përdorur në bujqësi ose pylltari që është projektuar për t'u rimorkiuar nga një traktor dhe që ndryshon ose i shtohet funksioneve të tij; ai mund të përfshijë një platformë ngarkese të projektuar dhe të ndërtuar për të marrë çdo mekanizëm dhe aparat të nevojshëm për këto qëllime dhe për të ruajtur përkohësisht çdo material, të prodhuar ose të nevojshëm gjatë punës; çdo automjet i synuar për t'u rimorkiuar nga një traktor dhe që ndërfut në mënyrë të përhershme një instrument ose i projektuar për të përpunuar materiale konsiderohet rimorkiator i ndërkëmbyeshëm nëse koeficienti i masës bruto të lejueshme teknikisht ndaj masës së pangarkuar të atij automjeti është më pak se 3,0.

m) "Sistem" nënkupton një grup pajisjesh të kombinuara për të përmbushur një funksion specifik në një automjet.

n) "Pjesë përbërëse" nënkupton një pajisje të synuar për të qenë pjesë e një automjeti që mund të jetë i përputhshëm në mënyrë të pavarur nga një automjet.

o) "Njësi e veçantë teknike" nënkupton një pajisje të synuar për të qenë pjesë e një automjeti që mund të jetë e përputhshme veçmas, por vetëm në lidhje me një ose më shumë tipa të specifikuar automjetesh.

p) "Prodhues" nënkupton personin fizik ose juridik që është përgjegjës për autoritetin e miratimit të tipit KE për të gjitha aspektet e procesit të miratimit tip dhe për garantimin e përputhshmërisë së prodhimit, pavarësisht nëse ai person duhet të përfshihet drejtpërdrejt në të gjitha fazat e ndërtimit të një automjeti, sistemi, pjesë përbërëse ose njësie të veçantë teknike; sa më poshtë konsiderohen, gjithashtu, të jenë prodhues:

i) çdo person fizik ose juridik që për përdorimin e vet, projekton, ka projektuar, prodhon ose ka prodhuar një automjet, sistem, pjesë përbërëse ose njësi të veçantë teknike;

ii) çdo person fizik ose juridik që është përgjegjës për garantimin e pajtueshmërisë me direktivën 2003/37/KE, në kohën kur një automjet, sistem, pjesë përbërëse ose njësi e veçantë teknike hidhet në treg ose hyn në shërbim.

Përfaqësuesi i një prodhuesi është person fizik ose juridik i vendosur në Komunitet, i caktuar nga prodhuesi për ta përfaqësuar atë tek autoriteti kompetent dhe për të vepruar në emër të tij, në fushën e direktivës 2003/37/KE.

Sa më poshtë kur përmendet termi "prodhues" duhet të kuptohet si prodhues ose përfaqësues i tij.

q) "Hyrje në shërbim" nënkupton përdorimin fillestar për qëllimin e tij të synuar brenda Komunitetit të ndonjë automjeti që nuk kërkon asnjë instalim ose rregullim nga prodhuesi ose një palë e tretë e caktuar nga ai para përdorimit të tij fillestar; data kur ai është regjistruar ose hedhur për herë të parë në treg konsiderohet data e hyrjes në shërbim.

r) "Autoritet i miratimit të tipit KE" nënkupton autoritetin në një shtet anëtar, në Republikën e

Shqipërisë është Drejtoria e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, në zbatim të ligjit "Kodi Rrugor në Republikën e Shqipërisë", që është përgjegjës për të gjitha aspektet e miratimit të tipit të një automjeti, sistemi, pjesë përbërëse ose njësie të veçantë teknike dhe që lëshon dhe, kur është e nevojshme, tërheq miratimin e tipit KE, shërben si pikë kontakti për autoritetet e miratimit të tipit KE në shtete të tjera anëtare dhe kontrollon masat e marra nga prodhuesi me qëllim garantimin e përputhshmërisë së produktit.

s) "Shërbim teknik" nënkupton organizatën ose organin që është caktuar si laborator testues për të kryer testime ose inspektime në emër të autoritetit të miratimit të tipit KE në një shtet anëtar; ky funksion mund të përmbushet, gjithashtu, nga vetë autoriteti i miratimit të tipit KE.

t) "Direktiva të veçanta" nënkupton direktivat e renditura në shtojcën II, kapitulli B.

u) "Certifikatë e miratimit të tipit KE" nënkupton një prej modeleve që shfaqet në shtojcën II, kapitulli C, ose shtojcën korresponduese të një direktive të veçantë që përcakton se cili informacion duhet të jepet nga autoriteti i miratimit të tipit KE.

v) "Dokument informativ" nënkupton një prej modeleve që shfaqen në shtojcën I, ose shtojcën korrespondues të një direktive të veçantë, që përcakton se cili informacion duhet të jepet nga aplikanti.

w) "Dosje informative" nënkupton dosjen e plotë ose dosjen që përmban veçanërisht të dhënat, skicat dhe fotografitë e kërkuara sipas shtojcës I dhe që aplikanti i jep shërbimit teknik ose autoritetit të miratimit të tipit KE, siç kërkohet nga dokumenti informativ i parashikuar në një direktivë të veçantë ose në direktivën 2003/37/KE.

x) "Paketë informacioni" nënkupton dosjen informative plus çdo raport testimi ose dokumente të tjera që shërbimet teknike ose autoriteti i miratimit të tipit KE ka shtuar në dosjen informative gjatë kryerjes së detyrave të tij.

y) "Tregues për paketën e informacionit" nënkupton dokumentin që përcakton përmbajtjen e paketës së informacionit që është numërtuar, siç duhet ose të shënuar në ndonjë formë tjetër, me qëllim identifikimin e qartë të të gjitha faqeve.

z) "Certifikatë përputhshmërie" nënkupton dokumentin e përcaktuar në shtojcën III, të dorëzuar nga prodhuesi, me qëllim që të vërtetojë se një automjet i caktuar, i miratuar sipas direktivës 2003/37/KE, pajtohet me të gjitha instrumentet rregullatore të zbatueshme në kohën e prodhimit të tij dhe që deklaron se ai mund të regjistrohet ose vihet në shërbim në të gjitha shtetet anëtare pa ndonjë inspektim shtesë.

Neni 3

Kërkesa për miratimin e tipit KE

1. Prodhuesi dorëzon një kërkesë për miratim të tipit KE pranë autoritetit miratues të një shteti anëtar. Ai shoqërohet me një dosje informative që përmban informacionin e kërkuar nga shtojca I.

Për sa i përket miratimit të tipit KE të sistemeve, komponentëve dhe njësive të veçanta teknike, dosja informative vihet, gjithashtu, në dispozicion për autoritetin e miratimit të tipit KE derisa miratimi i tipit KE të jepet ose refuzohet.

2. Në rastin e miratimit të tipit KE në shumë faza, informacioni që duhet të jepet përbëhet nga:

a) në fazën e parë: ato pjesë të dosjes informative dhe certifikatat e miratimit të tipit KE të kërkuara për një automjet të plotë që i korrespondon statusit të përfundimit të automjetit bazë;

b) në fazën e dytë dhe fazat e mëtejshme: ato pjesë të dosjes informative dhe certifikatat e miratimit të tipit KE që kanë lidhje me fazën aktuale të ndërtimit dhe një kopje të certifikatës së miratimit të tipit KE për automjetin e paplotë, të lëshuara në fazën e mëparshme; për më tepër prodhuesi jep një listë të hollësishme të ndryshimeve dhe shtesave që ai ka bërë në automjetin e paplotë.

3. Prodhuesi paraqet një kërkesë për miratimin e tipit KE të një sistemi, komponenti ose njësie të veçantë teknike pranë autoritetit të miratimit të tipit KE në një shtet anëtar. Ajo shoqërohet nga një dosje informative që kërkohet nga direktiva e veçantë.

4. Kërkesat për miratimin e tipit KE të një tipi automjeti, sistemi, komponenti ose njësie të veçantë teknike mund t'i paraqiten vetëm një shteti anëtar. Një kërkesë e veçantë paraqitet për çdo tip që duhet të miratohet.

Neni 4

Procesi i miratimit të tipit KE

1. Çdo shtet anëtar jep:

a) miratimin e tipit KE për tipat e automjeteve që pajtohen me të dhënat në dosjen informative dhe që, sipas kategorisë së tyre, përmbushin kërkesat teknike të të gjitha direktivave të veçanta të përcaktuara

në shtojcën II, kapitulli B;

b) miratimin i tipit KE në shumë faza për automjetet e paplota ose të përfunduara bazë që pajtohen me të dhënat në dosjen informative dhe që përmbushin kërkesat teknike të të gjitha direktivave të veçanta të përcaktuara në shtojcën II, kapitulli B;

c) miratimin e tipit KE të sistemit, komponentit ose njësisë së veçantë teknike për të gjithë tipat e sistemeve, komponentëve ose njësive të veçanta teknike, që pajtohen me të dhënat në dosjen informative dhe që përmbushin kërkesat teknike në përmbajtje të direktivës së veçantë korresponduese të renditur në shtojcën II, kapitulli B.

Kur sistemi, komponenti ose njësia e veçantë teknike që duhet të miratohet përmbush funksionin e tij ose ofron një tipar specifik vetëm në lidhje me pjesë të tjera të automjetit dhe kur, për këtë arsye, pajtueshmëria me një ose më shumë kërkesa mund të verifikohet vetëm kur sistemi, komponenti ose njësia e veçantë teknike që duhet të miratohet, operon në lidhje me pjesë të tjera automjeti, qoftë reale ose të simuluara, objekti i miratimit të tipit KE të sistemit, komponentit ose njësisë së veçantë teknike duhet për rrjedhojë të kufizohet.

Në këtë rast, certifikatat e miratimit të tipit KE për këtë sistem, komponent ose njësi të veçantë teknike tregojnë çdo kufizim në përdorimin e tij dhe çdo kusht për ta përshtatur atë. Respektimi i këtyre kufizimeve dhe kushteve verifikohet në kohën e miratimit të tipit KE të automjetit.

2. Nëse një shtet anëtar konstaton se një automjet, sistem, komponent ose njësi e veçantë teknike që pajtohet me dispozitat e paragrafit 1, është gjithsesi një rrezik serioz për sigurinë e rrugës, mjedisin ose sigurinë profesionale, ai mund të refuzojë të japë miratimin e tipit KE. Ai njofton menjëherë në lidhje me këtë shtetet e tjera anëtare dhe Komisionin, duke deklaruar arsyet mbi të cilat bazohet vendimi i tij.

3. Për çdo tip automjeti në lidhje me të cilin ato kanë dhënë, refuzuar të japin ose tërheqin miratimin e tipit KE, autoriteti miratues në çdo shtet anëtar brenda një muaji i dërgon një kopje të certifikatës së miratimit të tipit KE të shoqëruar me shtojcat e përcaktuara në kapitullin C të shtojcës II autoriteteve të miratimit të tipit në shtetet e tjera anëtare.

4. Autoriteti i miratimit të tipit KE në çdo shtet anëtar dërgon çdo muaj një listë që përmban të dhënat e parashtruara në shtojcën VI, të miratimeve të tipave KE për sistemet, komponentët ose njësitë e veçanta teknike që ai ka dhënë, refuzuar të japë ose tërheqë gjatë muajit në fjalë pranë autoriteteve të miratimit të tipit KE në shtetet e tjera anëtare.

Pas marrjes së një kërkese nga autoriteti i miratimit të tipit KE në një shtet tjetër, këto autoritete i dërgojnë atij menjëherë një kopje të certifikatës së miratimit të tipit KE për sistemin, komponentin ose njësinë e veçantë teknike në fjalë dhe/ose një paketë informacioni për çdo tip sistemi, komponent ose njësi të veçantë teknike në lidhje me të cilën ai ka lëshuar, refuzuar të lëshojë ose tërhequr miratimin e tipit KE.

Neni 5

Amendimet në miratimet e tipit KE

1. Shteti anëtar që ka dhënë miratimin e tipit KE merr masat e nevojshme për të garantuar që është informuar në lidhje me çdo ndryshim në të dhënat e përfshira në paketën e informacionit.

2. Një kërkesë për amendimin e një miratimi të tipit KE i paraqitet ekskluzivisht shtetit anëtar që ka dhënë miratimin fillestar të tipit KE.

3. Nëse, në rastin e miratimit të tipit KE, ndonjë e dhënë që përfshihet në paketën e informacionit ka ndryshuar, autoriteti i miratimit të tipit KE në shtetin anëtar që ka dhënë miratimin fillestar të tipit KE përgatit faqe të rishikuara të paketës së informacionit që janë të nevojshme, duke shënuar çdo faqe të rishikuar për të treguar qartë natyrën e ndryshimit dhe datën e rilëshimit.

Një version përfundimtar i përditësuar i paketës së informacionit, i shoqëruar nga një përshkrim i hollësishëm i amendimit, konsiderohet, gjithashtu, se përmbush këtë kërkesë.

4. Në çdo rast kur janë përgatitur faqet e ndryshuara ose një version përfundimtar i përditësuar, treguesi në paketën e informacionit që i bashkëlidhet certifikatës së miratimit të tipit KE ndryshohet, gjithashtu, për të treguar datat më të fundit të ndryshimit ose datën e versionit përfundimtar të përditësuar.

5. Amendimi konsiderohet të jetë një “shtesë” dhe autoriteti për miratimin e tipit në shtetin anëtar që ka dhënë miratimin fillestar të tipit KE lëshon një certifikatë të miratimit të tipit KE të rishikuar që mban një numër shtesë, i cili deklaron qartë arsyen për shtesën dhe datën e tij të rilëshimit në rastet e mëposhtme:

a) nëse kërkohen inspektime të mëtejshme;

b) nëse ka ndryshuar ndonjë informacion në certifikatën e miratimit të tipit KE, me përjashtim të shtojcave të tij;

c) nëse kërkesat e një direktive të veçantë që janë zbatuar në datën nga e cila hyrja e parë në

shërbim është ndaluar, kanë ndryshuar që prej datës kur paraqitet aktualisht në certifikatën e miratimit të tipit të automjetit KE.

6. Nëse autoriteti i miratimit të tipit KE në shtetin anëtar që ka dhënë miratimin fillestar të tipit KE, konstaton se një ndryshim në një paketë informacioni kërkon inspektime të mëtejshme ose testime ose kontrolle të reja, ai rrjedhimisht informon prodhuesin dhe lëshon dokumentet e përmendura në paragrafët 3, 4 dhe 5 vetëm pas kryerjes së testimeve ose kontrolleve që kanë sjellë rezultate të mjaftueshme.

Neni 6

Certifikata e përputhshmërisë dhe marka e miratimit të tipit KE

1. Në cilësinë e tij si mbajtës i një certifikate të miratimit të tipit KE të automjeteve, prodhuesi lëshon një certifikatë përputhshmërie.

Kjo certifikatë, modele të të cilave jepen në shtojcën III, shoqëron çdo automjet, qoftë i plotë ose i paplotë, të prodhuar në pajtim me tipin e miratuar të automjetit.

2. Për qëllime të taksimit ose regjistrimit të automjetit, shtetet anëtare, pas dhënies së një njoftimi, të paktën tre muaj përpara, Komisionit dhe shteteve të tjera anëtare, mund të kërkojnë që të dhëna, të cilat nuk përmenden në shtojcën III t'i shtohen certifikatës së përputhshmërisë, me kusht që këto të dhëna të deklarohen qartë në paketën e informacionit ose të mund të rrjedhin nga ajo me anë të një llogaritjeje të thjeshtë.

3. Në cilësinë e tij si mbajtës i një certifikate të miratimit të tipit KE për një sistem, pjesë përbërëse ose njësi të veçantë teknike, prodhuesi i bashkëngjit çdo pjese përbërëse ose njësie të prodhuar në përputhje me tipin e miratuar emrin ose markën tregtare, tipin dhe/ose, nëse direktiva e veçantë e parashikon këtë, markën ose numrin e miratimit të tipit KE.

4. Në cilësinë e tij si mbajtës i një certifikate të miratimit të tipit KE që, në përputhje me nenin 4(1)(c), përfshin kufizime mbi përdorimin e sistemit, pjesës përbërëse ose njësisë së veçantë teknike përkatëse, prodhuesi i jep çdo sistemi, pjesë përbërëse ose njësie të veçantë teknike informacion të hollësishëm mbi këto kufizime dhe përcakton kushtet për përshtatjen e tij.

Neni 7

Regjistrimi, shitja dhe hyrja në shërbim

1. Çdo shtet anëtar regjistron automjete të reja të miratuara, lejon shitjen ose hyrjen e tyre në shërbim për arsye që lidhen me ndërtimin dhe funksionimin e tyre vetëm nëse ato shoqërohen nga një certifikatë e vlefshme përputhshmërie.

Çdo shtet anëtar lejon shitjen e automjeteve të papërfunduara, por mund të refuzojë regjistrimin e tyre të përhershëm dhe hyrjen në shërbim deri në kohën kur ato të jenë përfunduar.

2. Çdo shtet anëtar lejon shitjen ose hyrjen në shërbim të sistemeve, pjesëve përbërëse ose njësive të veçanta teknike vetëm nëse këto sisteme, pjesë përbërëse ose njësi të veçanta teknike pajtohen me kërkesat e direktivave të veçanta të barasvlershme dhe kërkesat e përmendura në nenin 6 (3).

Neni 8

Përjashtimet

1. Kërkesat e nenit 7(1) nuk zbatohen për automjetet e synuara për përdorim nga forcat e armatosura, mbrojtja civile, shërbimet zjarrfikëse ose të rendit publik ose për automjetet tipat e të cilëve janë miratuar në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni.

2. Çdo shtet anëtar, me kërkesë të prodhuesit, mund të përjashtojë automjetet e përmendura në nenet 9, 10 dhe 11 nga një ose më shumë dispozita të një ose më shumë direktivave të veçanta.

Shtetet anëtare i dërgojnë çdo vit Komisionit dhe shteteve të tjera anëtare një listë të përjashtimeve të dhëna.

Neni 9

Automjetet e prodhuara në seri të vogla

Për automjetet e prodhuara në seri të vogla, numri i automjeteve të regjistruara, të ofruara për shitje

ose të vëna në shërbim çdo vit në çdo shtet anëtar, kufizohet në numrin maksimal të njësive të treguara në shtojcën V, seksioni A.

Çdo vit shtetet anëtare i dërgojnë Komisionit një listë të miratimeve të tipave KE të këtyre automjeteve. Shteti anëtar që jep këtë miratim të tipit KE dërgon një kopje të dokumenteve informative dhe certifikatën e miratimit të tipit KE dhe të gjitha shtojcat e tyre, autoriteteve miratuese në shtetet e tjera anëtare të caktuara nga prodhuesi, duke deklaruar natyrën e përjashtimeve që janë dhënë. Brenda tre muajve këto shtete anëtare vendosin nëse duhet të pranojnë miratimin e tipit KE për automjetet që duhet të regjistrohen brenda territorit të tyre dhe, nëse po, vendosin për numrin e automjeteve.

Neni 10

Automjetet e serisë së fundit

1. Për automjetet e serisë së fundit, me kërkesë të prodhuesit dhe brenda kufijve sasiorë të përcaktuar në shtojcën V, seksioni B, si dhe për periudhën e kufizuar të përcaktuar në nënparagrafin e tretë, shtetet anëtare mund të regjistrojnë dhe lejojnë shitjen ose hyrjen në shërbim të automjeteve të reja që pajtohen me një tip automjeti miratimi i të cilit nuk është më i vlefshëm.

Nënparagrafi i parë zbatohet vetëm për automjetet që:

a) janë në territorin e Komunitetit; dhe

b) shoqërohen nga një certifikatë e vlefshme përputhshmërie të lëshuar kur miratimi i tipit KE i automjetit përkatës ka qenë ende i vlefshëm, por që nuk ishte regjistruar ose vënë në shërbim para se miratimi i lartpërmendur të humbte vlefshmërinë e tij.

Ky opsion kufizohet në një periudhë prej 24 muajsh për automjetet e plota dhe 30 muaj për automjetet e përfunduara nga data e skadimit të miratimit të tipit KE.

2. Me qëllim të zbatimit të paragrafit 1, për një ose më shumë tipa automjetesh në një kategori specifike, prodhuesi duhet t'i paraqesë një kërkesë autoriteteve kompetente në çdo shtet anëtar të cenuar nga hyrja në shërbim e atij tipi automjeti. Kërkesa duhet të specifikojë arsyet teknike dhe/ose ekonomike në të cilat është bazuar.

Brenda tre muajve këto shtete anëtare vendosin nëse duhet të lejojnë apo jo regjistrimin e tipit të automjetit në fjalë në territorin e tyre dhe nëse po, vendosin për numrin e automjeteve.

Çdo shtet anëtar i cenuar nga hyrja në shërbim e këtyre tipave automjetesh është përgjegjës për të garantuar që prodhuesi i tyre të pajtohet me shtojcën V, seksioni B.

Neni 11

Papajtueshmëria e automjeteve, sistemeve, pjesëve përbërëse ose njësive të veçanta teknike

Për automjetet, sistemet, pjesët përbërëse ose njësitë e veçanta teknike të projektuara në përputhje me teknikat ose parimet që janë të papajtueshme me një ose më shumë prej kërkesave të një ose më shumë direktivave të veçanta:

a) Një shtet anëtar mund të japë një miratim të përkohshëm të tipit KE. Në këtë rast, brenda një muaji ai duhet t'i dërgojë një kopje të certifikatës së miratimit të tipit KE dhe shtojcat e tyre autoriteteve miratuese në shtetet e tjera anëtare dhe Komisionit. Në të njëjtën kohë ai i dërgon Komisionit një kërkesë për lejim për dhënien e miratimin të tipit KE sipas direktivës 2003/37/KE.

Kjo kërkesë duhet të shoqërohet nga një dosje që përmban informacionin e mëposhtëm:

i) arsyet për të cilat teknikat ose parimet përkatëse e bëjnë automjetin, sistemin, pjesën përbërëse ose njësinë e veçantë teknike të papajtueshëm me kërkesat e një ose më shumë prej direktivave të veçanta përkatëse;

ii) një përshkrim të sigurisë, mbrojtjes mjedisore ose çështje të ngritura të sigurisë profesionale dhe të masave të marra;

iii) një përshkrim të testimeve, së bashku me rezultatet e tyre, që tregon se niveli i sigurisë, mbrojtjes mjedisore dhe sigurisë profesionale të garantuar është minimalisht i barazvlefshëm me atë të garantuar nga kërkesat e një ose më shumë direktivave të veçanta përkatëse;

b) Brenda tre muajve nga marrja e dosjes së plotë, Komisioni i paraqet një projekt vendim komitetit të përmendur në nenin 20(1). Në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 20(2), Komisioni vendos nëse duhet të lejojë apo jo shtetin anëtar të japë një miratim të tipit KE sipas direktivës 2003/37/KE.

Vetëm kërkesa për lejim dhe projektvendimi i dërgohen shteteve anëtare në gjuhën (gjuhët) e tyre kombëtare;

c) Nëse kërkesa miratohet, shteti anëtar mund të japë një miratim të tipit KE sipas direktivës

2003/37/KE. Në këtë rast, vendimi duhet të deklarojë gjithashtu nëse duhet të vendosen kufizime mbi vlefshmërinë e këtyre miratimeve të tipit KE. Periudha e vlefshmërisë së miratimit të tipit KE nuk është në asnjë rast më pak se 36 muaj;

d) Kur kërkesa të veçanta i përshtaten progresit teknik në mënyrë të tillë që tipat e automjeteve, sistemeve, pjesëve përbërëse ose njësive të veçanta teknike të miratuara sipas këtij neni pajtohen me direktivat e ndryshuara, shtetet anëtare i shndërrojnë këto miratime të tipit KE në miratime të tipit KE që pajtohen me direktivën 2003/37/KE, duke lejuar kohën e nevojshme për ndryshimet e nevojshme ndaj komponentëve ose njësive të veçanta teknike, në veçanti, heqjen e referencave ndaj kufizimeve ose përjashtimeve;

e) Nëse nuk janë marrë masat e nevojshme për të përshtatur direktiva të veçanta specifike, vlefshmëria e miratimeve të tipit KE të dhëna sipas këtij neni mund të shtyhet me kërkesë të shtetit anëtar që ka dhënë miratimin e tipit KE, me anë të një vendimi tjetër të Komisionit;

f) Një përjashtim i dhënë për herë të parë sipas këtij neni mund të shërbejë si referencë për Komitetin e përmendur në nenin 20(1) për kërkesa të mëtejshme identike.

Neni 12

Barasvlershmëria

1. Duke vepruar me shumicë të cilësuar mbi një propozim të Komisionit, Këshilli mund të njohë barasvlershmërinë midis kushteve ose dispozitave për miratimin e tipit KE të automjeteve, sistemeve, pjesëve përbërëse dhe njësive të veçanta teknike të krijuara nga direktiva 2003/37/KE, së bashku me direktivat e veçanta dhe procedurat e krijuara nga rregulloret ndërkombëtare ose rregulloret e vendeve të treta në kuadër të marrëveshjeve shumëpalëshe ose dypalëshe ndërmjet Komunitetit dhe vendeve të treta.

2. Barasvlershmëria e miratimeve të tipit KE të lëshuara mbi bazën e direktivave të veçanta mbi mjetet motorike, siç përcaktohet në direktivën 70/156/KEE dhe të përcaktuara në shtojcën II, kapitulli B, pjesa II-A e këtij udhëzimi, në harmoni me direktivën 2003/37/KE, do të njihet.

3. Barasvlershmëria e miratimeve të tipit të lëshuara mbi bazën e rregulloreve UN/ECE që i bashkëlidhen Marrëveshjes së Rishikuar të vitit 1958, të përcaktuar në shtojcën II, kapitulli B, pjesa II-B të këtij udhëzimi, në harmoni me direktivën 2003/37/KE, do të njihet.

4. Barasvlershmëria e buletineve të testimeve të lëshuara mbi bazën e kodeve të standardizuara të OECD-së të përcaktuara në shtojcën II, kapitulli B, pjesa II-C të këtij udhëzimi, në harmoni me direktivën 2003/37/KE, njihet si alternativë ndaj raporteve të testimeve të hartuara sipas direktivave të veçanta.

Neni 13

Masat për garantimin e përputhshmërisë së prodhimit

1. Një shtet anëtar që jep një miratim të tipit KE merr masat e përmendura në shtojcën IV në lidhje me atë miratim për të verifikuar sipas rastit, në bashkëpunim me autoritetet e miratimit të tipit KE në shtetet e tjera anëtare, se janë marrë masat e mjaftueshme për të garantuar që automjetet, sistemet, pjesët përbërëse ose njësitë e veçanta teknike të prodhuara pajtohen me tipin e miratuar.

2. Një shtet anëtar që ka dhënë një miratim të tipit KE merr masat e përmendura në shtojcën IV në lidhje me atë miratim për të verifikuar sipas rastit, në bashkëpunim me autoritetet e miratimit të tipit KE në shtetet e tjera anëtare, se masat e përmendura në paragrafin 1 vazhdojnë të jenë të mjaftueshme dhe se pajisjet, sistemet, pjesët përbërëse ose njësitë e veçanta teknike të prodhuara vazhdojnë të pajtohen me tipin e miratuar.

Verifikimi për të garantuar se produktet pajtohen me tipin e miratuar kufizohet në procedurat e përcaktuara në seksionin 2 të shtojcës IV.

Neni 14

Detyrimi për dhënien e informacionit

Autoritetet kompetente të miratimit të tipit KE në shtetet anëtare informojnë njëri-tjetrin brenda një muaji për çdo tërheqje të miratimit të tipit KE dhe për arsyet në lidhje me një masë të tillë.

Neni 15

Klauzola garancie

1. Nëse një shtet anëtar konstaton se automjetet, sistemet, pjesët përbërëse ose njësitë e veçanta teknike të një tipi të caktuar paraqesin rrezik serioz për sigurinë e rrugëve ose sigurinë profesionale, megjithëse shoqërohen nga një certifikatë e vlefshme përputhshmërie ose janë shënjuar siç duhet, për një periudhë maksimale prej gjashtë muajsh ai mund të refuzojë regjistrimin e këtyre automjeteve ose të ndalojë shitjen ose hyrjen në shërbim në territorin e tij të këtyre automjeteve, sistemeve, pjesëve përbërëse ose njësive të veçanta teknike.

Ai njofton menjëherë në lidhje me këtë shtetet e tjera anëtare dhe Komisionin, duke deklaruar arsyet mbi të cilat bazohet vendimi i tij.

2. Në situatat e përshkruara në paragrafin 1, Komisioni hyn në konsultime me palët përkatëse sa më parë që të jetë e mundur.

Kur pas këtyre konsultimeve Komisioni nxjerr përfundimin:

a) se masa është justifikuar, ai informon menjëherë shtetin anëtar që ka filluar masën dhe shtetet e tjera anëtare;

b) se masa nuk është justifikuar, ai informon menjëherë shtetin anëtar që ka filluar masën dhe prodhuesin.

Kur vendimi i përshkruar në paragrafin 1 justifikohet për shkak të një boshllëku ligjor në një prej direktivave të veçanta, vendimi për ta mbështetur atë merret në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 20(2).

Neni 16

Mospajtimi me tipin e miratuar

1. Mospajtimi me tipin e miratuar ndodh kur konstatohen devijime nga të dhënat në certifikatën e miratimit të tipit KE dhe/ose paketën e informacionit dhe kur këto devijime nuk lejohen sipas nenit 5(3) nga shteti anëtar që ka dhënë miratimin e tipit KE.

Një automjet nuk duhet të konsiderohet se devijon nga tipi i miratuar kur arrihen kufijtë e lejueshëm nga direktiva të veçanta.

2. Nëse një shtet anëtar që ka dhënë miratimin e tipit KE konstaton se automjetet, sistemet, pjesët përbërëse ose njësitë e veçanta teknike të shoqëruara nga një certifikatë përputhshmërie ose që mbajnë markën e miratimit të tipit KE, nuk pajtohen me tipin që ai ka miratuar, ai merr masat e nevojshme për të garantuar se automjetet, sistemet, pjesët përbërëse ose njësitë e veçanta teknike të prodhuara pajtohen me tipin e miratuar.

Autoriteti për miratimin e tipit të automjeteve KE informon autoritetet e shteteve të tjera anëtare dhe Komisionin për masat e marra që mund të zgjerohen në tërheqjen e miratimit të tipit KE.

3. Autoriteti përgjegjës për miratimin e tipit KE të automjetit i kërkon shtetit anëtar që ka dhënë miratimin e tipit KE të sistemit, pjesës përbërëse, njësisë së veçantë teknike ose automjetit të papërfunduar, të marrë masat e nevojshme për të garantuar që automjetet e prodhuara pajtohen me tipin e miratuar në rast të:

a) miratimit të tipit KE të automjeteve kur mospajtueshmëria e një automjeti rrjedh ekskluzivisht nga mospajtueshmëria e një sistemi, pjesë përbërëse ose njësie të veçantë teknike; ose

b) miratimit të tipit KE në shumë faza kur mospajtueshmëria e një automjeti të përfunduar rrjedh ekskluzivisht nga mospajtueshmëria e një sistemi, pjesë përbërëse ose njësie të veçantë teknike që përbën pjesë të automjetit të papërfunduar ose të vetë automjetit të papërfunduar.

Ai informon menjëherë Komisionin në lidhje me këtë dhe zbatohet paragrafi 2.

Neni 17

Verifikimi i mospajtueshmërisë

Nëse një shtet anëtar konstaton se automjetet, sistemet, pjesët përbërëse ose njësitë e veçanta teknike të shoqëruara me një certifikatë përputhshmërie KE ose që mbajnë markën e miratimit të tipit KE, nuk pajtohen me tipin e miratuar, ai mund t'i kërkojë shtetit anëtar që ka dhënë miratimin e tipit KE, të verifikojë që automjetet, sistemet, pjesët përbërëse ose njësitë e veçanta teknike janë prodhuar në përputhje me tipin e miratuar.

Kjo masë merret sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në çdo rast, brenda gjashtë muajsh nga data e kërkesës.

Neni 18

Njoftimi i vendimeve dhe mjeteve ligjore në dispozicion

Të gjitha vendimet që refuzojnë ose tërheqin miratimin e tipit KE, që refuzojnë regjistrimin ose ndalojnë hyrjen në shërbim ose shitjen e bërë sipas dispozitave të miratuara në zbatim të këtij udhëzimi, në harmoni të plotë me direktivën 2003/37/KE, deklarojnë arsyet mbi të cilat ato bazohen.

Të gjitha këto vendime i njoftohen palës së interesuar, e cila njëkohësisht informohet për mjetet që i janë vënë në dispozicion sipas ligjeve në fuqi në shtetet anëtare dhe për afatet e lejuara për ushtrimin e këtyre mjeteve ligjore.

Neni 19

Amendimi i shtojcave të udhëzimit dhe direktivës 2003/37/KE, ose direktivave të veçanta

1. Masat e nevojshme për zbatimin e direktivës 2003/37/KE, në lidhje me subjektin e përmendur më poshtë, miratohen në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 20 (2):

a) ndryshimet e nevojshme për të përshtatur shtojcat me direktivën 2003/37/KE, ose

b) ndryshimet e nevojshme për të përshtatur dispozitat teknike të direktivave të veçanta, ose

c) prezantimin në direktiva të veçanta të dispozitave në lidhje me miratimin e tipit KE të njësive të veçanta teknike.

2. Nëse sipas vendimit 97/836/KE janë prezantuar rregulloret e reja ose amendimet në rregulloret ekzistuese që Komuniteti ka pranuar, Komisioni rrjedhimisht përshtat shtojcat me direktivën 2003/37/KE, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 20(2).

Neni 20

Komiteti

1. Komisioni ndihmohet nga një komitet.

2. Kur përmendet ky paragraf, zbatohen nenet 5 dhe 7 të vendimit 1999/468/KE, duke pasur parasysh dispozitat e nenit 8 të tij.

Periudha e përcaktuar në nenin 5(6) të vendimit 1999/468/KE caktohet çdo tre muaj.

3. Komiteti miraton rregulloren e tij të brendshme.

Neni 21

Njoftimi i autoriteteve për miratimin e tipit KE dhe shërbimet teknike

1. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit do të njoftojë Komisionin ashtu si dhe shtetet e tjera anëtare për emrat dhe adresat e:

a) autoriteteve të miratimit të tipit KE, aktualisht është Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor bazuar në ligjin "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" dhe, kur është e nevojshme, fushat për të cilat ata janë përgjegjës; dhe

b) shërbimeve teknike që ata kanë caktuar, duke specifikuar se për cilat procedura testimesh është caktuar secili prej këtyre organeve.

Shërbimet teknike të deklaruara duhet të përmbushin standardin e harmonizuar mbi funksionimin e laboratorëve të testimit (EN - ISO/IEC 17025:2000) në bazë të kushteve të mëposhtme:

i) një prodhues mund të caktohet si shërbim teknik vetëm kur kjo parashikohet shprehimisht nga direktiva të veçanta ose rregullore alternative;

ii) përdorimi i pajisjeve të jashtme nga një shërbim teknik, me pëlqimin e autoritetit të miratimit të tipit KE, është i autorizuar.

2. Një shërbim i caktuar teknik prezumohet të përmbushë standardin e harmonizuar të përmendur në paragrafin 1(b).

Megjithatë, kur është e nevojshme, Komisioni mund t'i kërkojë shteteve anëtare të sigurojnë të dhëna mbështetëse.

3. Shërbimet në vendet e treta mund të deklarohen si shërbime teknike të caktuara vetëm kur kjo parashikohet në një marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit dhe vendit të tretë përkatës.

Neni 22

Zbatimi

1. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit miraton këtë udhëzim në harmoni të plotë me direktivën 2003/37/KE dhe do të informojë Komisionin në lidhje me miratimin e këtij udhëzimi.

2. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit do t'i komunikojë Komisionit dispozitat kryesore të ligjit kombëtar në fushën e mbuluar nga direktiva 2003/37/KE.

Neni 23

Masat zbatuese për miratimin e tipit KE

1. Në lidhje me automjetet që i përkasin kategorive T1, T2 dhe T3, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor zbaton këtë udhëzim, në harmoni të plotë me direktivën 2003/37/KE, për:

a) tipat e rinj të automjeteve që nga 1 korriku 2005;

b) të gjitha automjetet e reja të hyra në shërbim që nga 1 korriku 2009.

2. Për kategoritë e automjeteve, përveç atyre të përmendura në paragrafin 1, pas miratimit të të gjitha direktivave të veçanta për një kategori automjeti, shtetet anëtare miratojnë direktivën 2003/37/KE:

a) tre vjet pas datës së hyrjes në fuqi të direktivës së fundit të veçantë që nuk është miratuar ende për tipat e rinj të automjeteve;

b) gjashtë vjet pas datës së hyrjes në fuqi të direktivës së fundit të veçantë që nuk është miratuar ende për të gjitha automjetet e hyra në shërbim.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, me kërkesë të prodhuesve, mund të zbatojnë këtë udhëzim, në harmoni të plotë me direktivën 2003/37/KE, për tipat e rinj të automjeteve që nga datat e hyrjes në fuqi të të gjitha direktivave të ngjashme të veçanta.

Neni 24

Shfuqizimi

1. Direktiva 74/150/KEE shfuqizohet me efekt që nga 1 korriku 2005.

2. Referencat ndaj direktivës 74/150/KEE interpretohen si referenca ndaj direktivës 2003/37/KE, dhe lexohen në përputhje me tabelën e ndërlidhjes të paraqitur në shtojcën VIII të këtij udhëzimi, në harmoni të plotë me direktivën 2003/37/KE.

Neni 25

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi